



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 3329/Prot  
2

Date 26/07/2023

VENDIM

Nr 12, date 21/07/2023

**“PËR LARGIMIN NGA SKEMA E PERFITIMIT TE BONUSIT TE QERASE,FAMILJET BANESATE TE CILEVE JANE DEMTUAR NGA TERMETI I DATES 26 NENTOR 2019, TE CILAT KANE PERFITUAR NGA GRANDET E RIKONSTRUKSIONIT DHE RINDERIMIT “**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1, shkronja “b”, të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, të ligjit nr. 96/2019 datë 18.12.2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.46 datë 09.12.2019 “Për pagesën e plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që janë dëmtuar nga termeti i datë 26.11.2019”, pika 8,Akti Normativ nr.37, date 24.12.2020 “Per zgjatjen e pageses se plote te qerases sipas vleres se tregut per familjet qe jane demtuar nga termeti i dates 26 Nentor 2019”,Relacionit te derguar nga mbikqyresi i punimeve ne lidhje me ecurine e punimeve ne godinat kolektive (nivel demtimi Ds4) me date 08.06.2023 ; referuar relacionit te paraqitur nga Komisioni i Posacem, Drejtoria e Sherbimeve Publike, DPKZHT-ja; Kryetari Bashkise, ne lidhje me familjet perfituese nga Grandet e Rikonstruksionit dhe Rindertimit (ndertim i banesave te reja individuale dhe apartamente) , Keshilli Bashkiak

**VENDOSI**

1.Largimin nga skema e perfitimit nga programi “Bonus Qeraje”, familjet sipas specifikimeve te pasqyres bashkelidhur projekt -vendimit.

2.Nderprerjen e menjehershme të pagesës së subvencionimit të bonusit të qirasë ,duke filluar nga muaj korrik 2023.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet

Drejtoria e Sherbimeve Publike

Drejtoria e Financave

D.P.K.ZH.T.

>Prefekti i Qarkut Lezhë

>Drejtoria e Sherbimeve Publike

>Drejtoria e Financave

>D.P.K.ZH.T.

>Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT  
Arber LEKA



KRYETARE E KESHILLIT  
Edlira LLESHI

